

Siguria e injeksioneve, eleminimi i mbetjeve

Trajnim online për fushatën e vaksinimit ndaj COVID-19


Iria Preza

Programi Kombëtar i Vaksinimit, ISHP

09 Janar 2021

Një injeksion konsiderohet i sigurtë për:

- **Individin që vaksinohet**, kur nje punonjes shendetesor, infermier / vaksinator perdor nje shiringe dhe nje age sterile dhe vepron sipas procedurave perkatese;
- **punonjesin shendetesor**, kur ai / ajo eviton shpimin nga gjilpera;
- **komunitetin**, kur mbeturinat e krijuara nga perdorimi i pajisjeve te injeksionit te procesit te imunizimit shkaterrohen ne menyren e duhur dhe nuk shkaktojne nivele te larta e te demshme te ndotjes dhe demtime.




Llojet e pajisjeve injektuese

Pajisje

1. Shiringa vete-shkaterruese (AD)*
2. Paisje injektuese (AD) te mbushura me pare
3. Shiringa dhe age nje here perdorimshe (jo AD)
4. Shiringa dhe age shume perdorimshe

Shenime per secilen

1. Pajisje qe nuk lejojne perdorim me shume se nje here, pasi vete-blokohe.
2. Te disponueshme vetem per disa lloje vaksinash
3. Vetem per qellime hollimi
4. Nuk rekomandohen




Menyra te thjeshta per te permiresuar sigurine e injektimit

- Pergatisni injeksionin ne nje zone te caktuar dhe te paster ku gjaku dhe lengje te tjera trupore nuk jane te pranishme.
- Pergatisni secilen doze menjehere para administrimit te saj, **mos pergatisni nje numer te madh shiringash para kohe.**
- Asnjehere mos e lini agen te ngulur ne flakonin e vaksines.
- Ndiqni rekomandimet specifike per perdorimin, ruajtjen dhe mirembajtjen e vaksines.
- Ndiqni procedura te sigurta per hollimin e vaksines.




Menyra te thjeshta per te permiresuar sigurine e injektimit

- Perdorni age dhe shiringe sterile per hollimin e cdo flakoni.
- Pas perdorimit hidhni shiringen ne nje kuti sigurie **pa i rivendosur kapakun.**
- Kontrolloni paketimin me shume kujdes. Hidheni nje shiringe ose nje age nese paketimi eshte shpuar, grisur ose demtuar ne cfaredolloj menyre.
- Mos prekni asnje pjese te ages. Hidheni shiringen qe ka prekur cfaredolloj siperfaqeje jo sterile.
- Vaksinat e holluara duhet te hidhen ne fund te sesionit ose pas 6 oresh, cilado procedure qe te jete me e shpejte.



Si duhet te parandalojme demtimet nga shpimi i ageve?

- Minimizoni mbajtjen e ageve dhe shiringave neper duar;
- Rregulloni hapesiren e punes ne menyre qe te shmangim demtimet;
- Vendosni individin në pozicionin e duhur per injeksion;
- Mbani nje kuti sigurie prane vendit ku kryhet vaksinimi.



Montimi dhe perdorimi i kutive te sigurise per shiringat



- Shikoni figurat ilustruese te montimit te kutise se sigurise.
- Mbani nje kuti sigurie prane vendit ku kryhet vaksinimi.
- Hidheni shiringen menjehere ne kutine e sigurise pas perdorimit.
- Mbylleni kutine e mbushur dhe zevendesojeni me nje tjetër.
- Mos e mbi mbush kutine e sigurise



Perdorimi i kutive të tjera

Kuti të tjera te vendosura në hapësirën e punës mund të përdoren për:

- hedhjen e flakonëve të përdorur
- Per mbetjet e tjera si: pambuku, doreza, amballazhime të shiringave, etj.

Pse eshte e rendesishme qe ti eliminojme mbeturinat e mprehta ne menyren e duhur?

- Eliminimi ne nje menyre jo te sigurte mund te perhape disa prej semundjeve.
- *Te rrezikshme per shendetin*
- Vendosja ose hedhja e shiringave dhe ageve te perdorura ne mjedise te hapura ose ne toke e ve shoqerine ne rrezik. Shume shpesh, femijet jane viktimat e pafata te demtimeve nga shpimi i ageve, si pasoje e hedhjes se tyre ne menyre jo te sigurte.
- Hedhja e shiringave dhe ageve te perdorura ne lume ndot ujin qe perdoret per te pire dhe per te lare.
- *Te rrezikshme per mjedisin*

Të gjitha mbetjet do asgjësohen sipas rregullave në vend për menaxhimin e mbetjeve.